



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE

PA1 Nr.03-381

13.12.2023

Shkup

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.42/20, 77/21 dhe 154/23) dhe në lidhje me nenin 98 paragrafi (2) nga Ligji i njëjtë, neni 14 paragrafi (2) i Rregullores për teknikat e reja të reklamimit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.56/15), pika 5 dhe pika 14 e Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës (Teksti i pastruar) ark.nr.01-4139/1 datë 07.11.2022, Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore, ark.nr.10-4472/1 datë 01.12.2023 dhe Konkluzionin ark.nr.02-4550/4 datë 12.12.2023, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, në seancën e 39-të mbajtur më 12.12.2023, miratoi si vijon:

Aktvendim për ndërmarrje të masës – vërejtje publike

1. PUBLIKISHT PARALAJMËROHET Shoqëria Tregtare Radiodifuzive (SHTR) ALSAT-M SHPK Shkup, për shkeljen e kryer të nenit 98 paragrafi (2) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (LSHMAAV) dhe neni 14 paragrafi (2) të Rregullores për teknika të reja të reklamimit, të mënyrës që në kuadër të shërbimit programor televiziv të radiodifuzerit, transmetuar më 7 nëntor 2023, në edicionet e serialeve artistike " Mos më braktis", " Çakër-familja e madhe " dhe " Vajza" ime e vogël", janë transmetuar pop-ap/ reklama me ekran të ndarë që mbulojnë pjesë thelbësore të veprimit dramatik.

Shkelja nga paragrafi (1) i kësaj pike është përcaktuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore,ark.nr.10-4472/1 datë 01.12.2023, si pjesë përbërëse e këtij Aktendimi si Shtojcë nr. 1.

2. UDHËROHET SHTR ALSAT-M SHPK Shkup, që në afat prej 10 (dhjetë) ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit të harmonizon punën e tij me dispozitat e LSHMAAV dhe RRTRR.

3. Pas skadimit të afatit përcaktuar në pikën 2 të këtij Aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i përcaktuar në pikën 1 të këtij aktvendimi, ka vepruar sipas aktvendimit.

4. Ky Aktvendim është përfundimtar dhe dita e miratimit të tij llogaritet dita e çertifikimit në Arkivin e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Agjencia).

A r s y e t i m

Agjencia në bazë të nenit 28 të LSHMAAV është kompetente për të kryer mbikëqyrje kontrolli (monitorim) të programeve të transmetuesve dhe ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizuale sipas kërkesës, si dhe të paketave programore që ritransmetohen nga operatorët e rrjeteve publike të komunikimit elektronik në aspekt të respektimit të dispozitave nga ligji i cituar, lejeve, çertifikatave të dhëna për regjistrim, aktet nënligjore dhe aktet të tjera miratuar nga Agjencia.

Në pajtim me nenin 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë ndërmerr masë për vërejtje publike në pajtim me këtë ligj, në rastet kur ka shkelje të dispozitave të LSHMAAV dhe akteve nënligjore të miratuara në bazë të Ligjit, si dhe të kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në leje dhe akte të tjera të Agjencisë.

Në pajtim me nenin 98 paragrafi (2) të LSHMAAV rregullat për teknikat e reja të reklamimit i përcakton Agjencia, dhe në pajtim me nenin 14 paragrafi (2) të RRTRR, nëse reklama në ekran të ndarë futet mbi përmbajtjen e programit, atëherë reklama në ekran të ndarë nuk duhet të jetë më e madhe se $\frac{1}{4}$ e pjesës së dukshme të ekranit, e cila nuk duhet të mbulojë pjesët thelbësore të veprimit.

Në kuadër të kompetencave të veta ligjore, Agjencia nëpërmjet Sektorit për çështje programore, më 1 dhjetor 2023, ka kryer mbikëqyrje të rregullt programore (monitorim) të shërbimit programor televiziv të SHTR ALSAT-M SHPK Shkup, të transmetuar më 7 nëntor 2023 në nivel shtetëror, në të cilin ka konstatuar shkelje të nenit 98 paragrafi (2) (për kushtet e reklamimit dhe teleshoping) nga LSHMAAV, pra të nenit 14 paragrafi (2) të RRTRR (ku me reklamë në ekran të ndarë nuk duhet: - të mbulohen pjesët thelbësore të veprimit, personazhet ose nëntitullin; - për të mos cënuar integritetin e programit; - për të mos mbuluar logon e ofruesit të shërbimit audiovizual, si dhe shenjat për kategorinë e programit, për vendosjen e produktit dhe informacione të tjera për natyrën dhe/ose karakteristikat e programit). Në edicionet e serive artistike: "Mos më braktis", "Çakër-familja e madhe" dhe " Vajza" ime e vogël", në kundërshtim me nenin 14 paragrafi (2) të RRTRR, me pop - ap/reklama në ekran të ndarë (specifikuar hollësisht në pikën 7, Konstatimi nga mbikëqyrja dhe Raporti me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore, ark.nr.10-4472/1 datë 01.12 2023, si pjesë përbërëse e këtij Aktvendimi me Shtojcë nr.1.), disa herë janë mbuluar pjesët thelbësore të veprimit dramatik.

Në pajtim me nenin 23 paragrafi (3) të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë drejtuar SHTR ALSAT-M SHPK Shkup, më 04.12.2023, ka dërguar Shkresë ark.nr.10- 4472/2 datë 04.12 2023, me të cilin i dorëzoi Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore, ark.nr.10-4472 /1datë 01.12.2023, që në afat prej 7 (shtatë) ditë pune nga dita e pranimit të shkresës, drejtuar Këshillit të Agjencisë të dorëzon deklaratë me shkrim për shkeljen e kryer të dispozitave nga LSHMAAV dhe RRTRR. Shkresa është pranuar në mënyrë të rregullt nga transmetuesi më 05.12.2023 , për të cilën në afatin e paraparë SHTR ALSAT-M SHPK Shkup, ka dorëzuar deklaratë me shkrim për shkeljen e kryer të dispozitave të LSHMAAV dhe RRTRR, me nr.y në ark.10-4472/3 të datës 05.12.2023. Këshilli i Agjencisë në seancën e mbajtur më 12.12.2023, ka shqyrtuar lëndën Raport me shkrim dhe deklaratën e dorëzuar me shkrim dhe ka konstatuar që SHTR ALSAT-M SHPK Shkup i shqiptohet masë – vërejtje publike.

Rrjedhimisht nga sa mësipër, në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 nga LSHMAAV, dhe në lidhje me nenin 98 paragrafi (2) nga Ligji i njëjtë, neni 14 paragrafi (2) të RRTRR, pika 5 dhe pika 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprimin sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masave, Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-4472/1 datë 01.12.2023 dhe Konkluzionin ark.nr. 02-4550/4 datë 12.12.2023, për shkak të konstatimit të mosrespektimit të dispozitave të LSHMAAV dhe RRTRR, përcaktuar në pikën 1 të këtij Aktvendimi, Këshilli i Agjencisë, në seancë e mbajtur më 12.12.2023, miratoi Aktvendim me të cilin publikisht paralajmëron SHTR ALSAT-M SHPK Shkup dhe urdhërohet që në afat prej 10 (dhjetë) ditësh nga dita e pranimit të afatit përcaktuar në pikën 2 të këtij Aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i cekur në pikën 1 të këtij aktvendimi, ka vepruar sipas aktvendimit.

Në pajtim me nenin 24 të LSHMAAV, ky Vendim është përfundimtar dhe kundër këtij aktvendimi radiodifuzeri ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

Bazuar në sa më sipër, u miratua aktvendim si në dispozitiv.

Shtojcë (1):

- 1) Raport me shkrim mbi mbikëqyrjen e kryer programore, ark.nr.10- 4472/1 datë 01.12.2023.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuele
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI,d.v.**

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi radiodifuzeri ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit.